



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
MUNICIPAL GLLOGOC

01 Nr. 400/03-20227
02/06/2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Republika e Kososës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Komuna e Gllogovit
Opština Gllogovac-Municipality of Gllogoc

| | |
|---|---|
| REPUBLICA KOSOVES KOMUNA GLLOGOC REPUBLIC OF KOSOVO MUNICIPAL GLLOGOC MUNICIPALITY OF GLLOGOC | MINISTRIA E KULTURËS, RINISE DHE SPORTIT MINISTRY OF CULTURE, EDUCATION AND SPORTS |
| Nr.Nr. 02 | Shëndet Lloji 03 |
| Nr. Prot/Viu. 290717015 | |
| Data. 04.06.2025 | |
| Nënshkrimi.....  Prishqimi | |

MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM

LIDHUR NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

DHE

KOMUNËS SË DRENASIT

W

1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT PËR BASHKËPUNIM

Krijimi i kornizës ligjore për bashkëpunimin dhe bashkë-financimin e zbatimit të projektit për ndërtimin e stadiumit të qytetit në Drenas- Faza e tretë.

2. AUTORITETET

2.1. Qëllim i memorandumit për bashkëpunim (në tekstin e mëtejmë: Memorandumi) do të përbushet nga:

2.1.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në njëren anë, dhe

2.1.2. Komuna e Drenasit, në anën tjeter.

(në tekstin e mëtejmë: Palët).

3. OBLIGIMET E PALËVE

3.1. OBLIGIMET E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT (në tekstin e mëtejmë: MKRS)

3.1.1. MKRS merr përsipër përbushjen e obligimeve si në vijim:

3.1.1.1. Sigurimin e mjeteve financiare, në shumë prej 4,500,000.00 € (Katër milion e pesëqind mijë euro), për vitin 2025, 2026 dhe 2027, për bashkë-financimin e zbatimit të projektit për ndërtimin e stadiumit të qytetit në Drenas- vazhdimi i fazës së dytë të ndërtimit, nga vlera e parashikuar e kontratës prej 5,375,000.00€ (Pesë milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë euro) nga kodi i projektit: 19709, me titull: "Stadioni në Drenas", të Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës.

3.1.1.2. Cakton zyrtarët përgjegjës për mbikëqyrjen e përshtatshmërisë së procedurave ligjore nëse të njëjtat janë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për të gjitha fazat e procedurës së kontraktimit të punëve për realizimin e projektit si dhe ofron komente dhe udhëzime, akordimi i të cilave është kusht për vazhdimin e mëtejmë të fazave të zbatimit të këtij MiB;

3.1.1.3. Propozimin e një (1) apo më shumë anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e tenderëve të cilët emërohen nga Komuna e Drenasit si autoriteti që udhëheqë procedurat e prokurimit;

3.1.1.4. Vëzhgimin e zbatimit të kontratës/ projektit në baza të rregullta periodike, përmes emërimit të zyrtarit përgjegjës përvendosur nga Komuna e Drenasit;

3.1.1.5. Vëzhgimin e kontrollit të cilësisë së përgjithshme të zbatimit të kontratës/ projektit duke përfshirë të cilësisë së materialeve, të produkteve dhe të mjeshtërive si dhe të sasive ndër të tjera, në baza të rregullta periodike, përmes emërimit të zyrtarit përgjegjës përvendosur nga Komuna e Drenasit;

3.1.1.6. Zbatimin e detyrimeve financiare në shumën e përcaktuar me paragrafin 3.1.1.1., pas pranimit të dokumentacionit, të miratuar dhe të vërtetuar, të menaxhimit të kontratës/ projektit dhe të mbikëqyrjes teknike, nga paragrafi 3.2.1.7. dhe 3.2.1.8., duke përfshirë (a.) të origjinalit të situatës së punëve të përfunduara, të faturës përkatëse dhe të raportit teknik, (b.) të kopjes së kontratës, të para-masës dhe të para-llogarisë dhe të gjitha pjesëve tjera përbërëse të kontratës, si dhe (c.) të origjinalit të shkresës përcjellëse, të përgatitur nga Kryetari i komunës (Komuna e Drenasit) për përpunim të pagesës nga Komuna, dhe të dorëzuara përmes Zyrtarit përgjegjës

ndërlidhës (Komuna e Drenasit); si dhe ndarjen formale, të dokumentacionit të miratuar dhc të vërtetuar, të zbatimit të detyrimeve financiare, me Komunën e Drenasit.

- 3.1.1.7. Sigurimin e zbatimit të këtij memorandumi, të bashkërendimit dhe të mbarëvajtjes përgjatë gjithë procesit, përmes emërimit të zyrtarit përgjegjës ndërlidhës, me vendim të prerë.
- 3.1.1.8. Bashkëpunimin me Komunën e Drenasit për zbatimin e projektit në tërësi, në funksion të qëllimit të këtij memorandumi.

3.2. OBLIGIMET E KOMUNËS SË DRENASIT

(në tekstin e mëtejmë: Komuna)

- 3.2.1. Komuna merr përsipër përbushjen e obligimeve si në vijim:
 - 3.2.1.1. Sigurimin e mjeteve financiare, në shumë prej 875,000.00 € (Tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë euro), për vitin 2025, 2026 dhe 2027, për bashkë-financimin e zbatimit të projektit për ndërtimin e stadiumit të qytetit në Drenas- Faza përfundimtare, nga vlera e parashikuar e kontratës prej 5,375,000.00€ (Pesë milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë euro), nga kodi i projektit përkatës, i Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës.
 - 3.2.1.2. Sigurimin e projektit për ndërtimin e stadiumit të qytetit në Drenas- Faza përfundimtare, duke përfshirë një deklaratë të kontrollit, të pranimit dhe të konfirmimit të plotësisë dhe të cilësisë teknike si dhe të verifikimit dhe të konfirmimit të vlerës financiare të projektit përkatës, lëndë e këtij memorandumi, dhe më pas dorëzimin tek MKRS, para inicimit të procedurës së prokurimit.
 - 3.2.1.3. Sigurimin e të gjitha lejeve të zbatueshme, brenda afateve të përcaktuara ligjore, për zbatimin e projektit, si dhe dorëzimin përkatës tek MKRS, para inicimit të procedurës së prokurimit.
 - 3.2.1.4. Sigurimin e ndërlidhjes dhe të bashkëveprimit me ndërmarrjet publike përgjegjëse për sistemet e furnizimit me ujë, të largimit të ujerave të zeza dhe atmosferike, si dhe të furnizimit me energji elektrike, për sistemet e telekomunikacionit, gjatë periudhës së zbatimit të projektit.
 - 3.2.1.5. Sigurimin e gjithë dokumentacionit tjeter të nevojshëm, ligjor, finanziar dhe teknik, në bazë të kërkesës nga MKRS, në funksion dhe në mbështetje të përbushjes së obligimeve të marra nga palët përmes këtij memorandumi.
 - 3.2.1.6. Zhvillimin dhe konsultimin paraprak me MKRS të dokumentacionit administrativ, teknik dhe finanziar që kërkohen sipas ligjit në procedurë të prokurimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në kërkesën për inicim, dosjen e tenderit dhe rrjedhimisht hartimin e termave të referencës, specifikimeve teknike dhe të çfarëdo kriteri tjeter të përzgjedhjes të cilat, para publikimit kërkijnë miratim paraprak të MKRS -së;
 - 3.2.1.7. Udhëheqjen e procedurës së prokurimit, si dhe ndarjen formale të dokumentacionit të kërkesës, të procedurës së prokurimit dhe të kontratës, të miratuar dhe të vërtetuar, me MKRS.
 - 3.2.1.8. Emërimin e anëtarëve të Komisionit të vlerësimit nga të cilët, nëse Komisioni do të ketë tre (3) anëtarë, një (1) duhet të propozohet nga MKRS, ndërsa nëse Komisioni do të ketë pesë (5) anëtarë, dy (2) duhet të propozohen nga MKRS.
 - 3.2.1.9. Udhëheqjen e zbatimit të kontratës/ projektit në baza të rregullta kohore, përmes emërimit të zyrtarit përgjegjës për menaxhimin e kontratës/ projektit, me vendim të prerë, si dhe ndarjen formale të dokumentacionit, të miratuar dhe të vërtetuar, të menaxhimit të kontratës/ projektit, me MKRS.

- 3.2.1.10. Udhëheqjen e kontrollit të cilësisë së përgjithshme gjatë zbatimit të projektit të hollësishëm (zbatues/ kryesor), duke përfshirë të cilësisë së materialeve, të produkteve dhe të mjeshtërive si dhe të sasive ndër të tjera në baza të rregullta kohore, përmes emërimit të zyrtarit ose zyrtareve përgjegjës për mbikëqyrjen teknike, me vendim të prerë, si dhe ndarjen formale të dokumentacionit, të miratuar dhe të vërtetuar, të mbikëqyrjes teknike, me MKRS.
- 3.2.1.11. Zbatimin e detyrimeve financiare në shumën e përcaktuar me paragafin 3.2.1.1., pas pranimit të dokumentacionit, të miratuar dhc të vërtetuar, të menaxhimit të kontratës/ projektit dhe të mbikëqyrjes teknike, nga paragrafi 3.2.1.7. dhe 3.2.1.8., duke përfshirë (a.) të originalit të situatës së punëve të përsfunduara, të faturës përkatëse dhe të raportit teknik; si dhe ndarjen formale, të dokumentacionit të miratuar dhe të vërtetuar, të zbatimit të detyrimeve financiare, me MKRS.
- 3.2.1.12. Sigurimin e zbatimit të këtij memorandumi, të bashkërendimit dhe të mbarëvajtjes përgjatë gjithçë procesit, përmes emërimit të zyrtarit përgjegjës ndërlidhës, me vendim të prerë.
- 3.2.1.13. Bashkëpunimin me MKRS për zbatimin e projektit në tërësi, në funksion të qëllimit të këtij memorandumi.

4. ZBATIMI

Palët përcjellin dhc mbështesin zbatimin e memorandumit dhe udhëzojnë mc kohë për veprimet që duhet të ndërmarrë deri në arritjen e qëllimit.

5. MUNDËSIA E NDËRPRERJES SË MEMORANDUMIT PËR BASHKËPUNIM DHE RRETHANAT E PAPARASHIKUARA

- 5.1. Ndërprerja e memorandumit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve.
- 5.2. Në rast se zbatimi i memorandumit duhet të ndërpitet për shkak të ndodhive të Fuqisë mbinatyrore "Vis major" dhe rrëthanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmarrë.

6. AFATI I ZBATIMIT

Afat i përfundimtar për arritjen e qëllimit të këtij memorandumi është periudha përgjatë viteve 2025, 2026 dhe 2027.

7. AMANDAMENTIMI

Ky memorandum mund të ndryshohet apo plotësohet në bazë të një Marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë memorandum, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në bashkëpunim në të ardhmen, apo në një amendament të këtij memorandumi, të nënshkruar nga palët e kësaj marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

8. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRËVESHJEVE

Palët do të përpiken që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidh rastet e tillë.

9. KOPJET DHE GJUHËT E MEMORANDUMIT PËR BASHKËPUNIM

Ky memorandum është përpiluar në gjuhën shqipe dhe në dy (2) origjinale, përkatësisht nga një (1) original për secilën palë.

10. HYRJA NË FUQI

Ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

Bislim BISLIMI

Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sportit



Ramiz LLADROVCI

Kryetar,
Komuna e Drenasit

Nënshkruar më 01/06/2025, në Prishtinë